

Mungesa e Selenit

Cili është suplementi më i mirë për t'a shmangur?

Mungesa e selenit mund t'i sëmurë shumë kafshët. Gjithsesi, duhet treguar kujdes ndaj formave të ndryshme të selenit. Lopët mund t'i përthithin dhe shfrytëzojnë ato në mënyra të ndryshme.



Ashtu si për fosforin dhe magnezin, edhe për selenin ka lloje të ndryshme lidhjesh. Në treg ka burime inorganike si selenitnatriumi (në formë të mbrojtur dhe të pambrojtur nga rumeni) dhe selenatnatriumi, si dhe burime organike si seleni në formën e (procesi i fermentimit të „Sakarose ceravitaë“). Është e rëndësishme që fermeri të dijë se cilat nga këto forma është më efektive. Kështu, në treg ka prej kohësh ushqime me minerale, si dhe suplemente me një nga këto burime ose edhe me kombinimin e të trejave. Arsyeja për këtë, është që ato kanë përdorime të ndryshme. P.sh. seleniti i natriumit reduktohet në rumen dhe kafsha mund të përthithë vetëm 50% të sasisë së marrë, pjesa tjetër eliminohet me jashtëqitjen. Nga ana tjetër, seleniti i natriumit me mbrojtje ndaj rumenit, del i pandryshuar nga rumeni dhe mund të përthithet nga zorra e hollë. Edhe seleni organik në formën e majasë mund t'a kalojë këtë vështirësi dhe ka gjithashtu efekte shtesë, pasi seleni

në sasi të lartë transferohet nëpërmjet placentës tek viçi i palindur dhe mund të merret më vonë edhe nëpërmjet qumështit.

Studim me tre grupe

Në një studim në terren në kuadër të një pune diplome në universitetin e Hohenheim-it, u studiua ndikimi i dhënies së selenit tek lopët e qumështit në rrethin e Ansbach (D). Eksperimenti zgjati nga data 1 Dhjetor 2011 deri në 15 Mars 2012 dhe filloi me një fazë sinkronizimi, gjatë së cilës të gjitha fermat përdorën vetëm selenit natriumi si burimin e vetëm të selenit. Më pas 15 tufat u ndanë në 3 grupe, Grupi 1 “inorganik”- selenit natriumi, Grupi 2 “inorganik”- selenit natriumi me mbrojtje ndaj rumenit dhe Grupi 3 “organike”- maja seleni Sel-Plex® (Alltech). Sasia standarde e suplementit ishte 0,3 mg selen për çdo kg racion të përzier, dhe sasia e suplementit u përcaktua në përputhje me racionin përkatës inkl. ushqimin me minerale. Ajo që përbënte interes për këtë studim, ishte përmbajtja e selenit në mostrat e gjakut dhe të qumështit, si dhe aktiviteti i glutathion peroksidase (*Glutathione Peroxidase* GSHPx) në gjak nga 10 kafshë për çdo fermë nga fillimi deri në fund të studimit.

Majaja e selenit shfaq përmbajtjet më të larta.

Analiza e të dhënave të nxjerra nga ky studim tregon ndryshime domethënëse ndërmjet këtyre tre suplementeve (shih tabelën). Midis dy suplementeve inorganike kishte ndryshime të dukshme: tek seleniti i natriumit me mbrojtje ndaj rumenit u vu re një sasi më e madhe e selenit në gjakun e plotë dhe në plazmën e gjakut, si dhe një aktivitet i lartë i enzimës në krahasim me selenitin e natriumit. Suplementi organik shfaqti sasi më të larta tek të gjithë parametrat e matur në krahasim me variantet inorganike të selenit, pasi rritja e vlerave në gjak, plazmë dhe qumësht ishte shumë e lartë. Përveç kësaj, megjithëse fermat pjesëmarrëse kishin arritur një status të lartë të selenit që para studimit, ndryshimet midis suplementeve të selenit ishin të dukshme.

Vlerat mesatare dhe rëndësia statistike e parametrave të studiuar duke krahasuar tre grupe të trajtuara.				
Burimi i selenit	Përmbajtja e selenit në gjakun e plotë [µg/l]	Përmbajtja e selenit në plazmë [µg/l]	Aktiviteti i GSHPx U/g Hb]	Përmbajtja e selenit në qumësht [µg/l]
Inorganik: Selenit natriumi	189,8	73,9	279,8	0,0265

Inorganik: Selenit natriumi me mbrojtje ndaj rumenit (Sil Sel 1%, HGS)	231,6	88,6	311,6	0,0270
Organik: Maja seleni (Sel-Pflex®, Alltech)	255,3	107,9	321,6	0,0545